

Nr.04-04-140/4

АМБАСАДА НА РЕПУБЛИКА  
МАКЕДОНИЈА ВО БЕРН



АМБАСАДА E REPUBLIKËS SË  
МАQEDONISË NË BERN

Kirchenfeldstrasse 30, CH-3005 Bern, Tel. 0041313520002, Fax. 0041313520037

Data: 13.02.2019

Ambasada e Republikës së Maqedonisë në Bern ka nderin tju njoftoj si në vijim:

Komisioni Shtetërorë Zgjedhor në seansën e mbajtur më 08.02.2019 miratoi Ftesë publike për qasje (rishikim) në Listën zgjedhore për votim jashtë vendit për zgjedhjet për President (Presidenciale) të Republikës së Maqedonisë – të cilat do të mbahen më 20 prill 2019 në Ambasadën e Republikës së Maqedonisë në Bern.

Ftohen të gjithë shtetasit e Republikës së Maqedonisë me qëndrim në Konfederatën Zvicërane, të cilët shprehin dëshirë për realizim të së drejtës së tyre zgjedhore – të votojnë, që në periudhën prej 23 shkurt deri më 14 mars 2019, të qasen (rishikojnë) në Listën zgjedhore në hapësirat e Përfaqësisë Diplomatike-Konsullore, e cila gjendet në adresën Kirchenfeldstrasse 30, 3005 Bern.

Qasja mund të bëhet edhe përmes web aplikacionit në internet faqen në vijim:  
<http://www.sec.mk>

Në periudhën prej 08 shkurt deri më 14 mars 2019, paraqitja për votim, e nënshkruar, dorëzohet deri te Përfaqësia Diplomatike Konsullore, në adresën e lartëshënuar ose përmes web aplikacionit në internet faqen e Komisionit Shtetëror Zgjedhor: <http://www.sec.mk>

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët më parë e kanë paraqitur qëndrimin e përkohshëm jashtë shtetit para organeve kompetente të Republikës së Maqedonisë, paraqesin vetëm kërkesë.

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët më parë nuk e kanë paraqitur qëndrimin e përkohshëm jashtë shtetit para organeve kompetente të Republikës së Maqedonisë obligohen të sjellin kopje nga dokumentet personale si fakt për lejeqëndrim jashtë vendit (Ausweis- Permis de séjour - *Permesso di Soggiorno*).

Votimi do të mbahet më 20.04.2019, në periudhën prej orës 07:00 deri në orën 19:00, në hapësirat e Përfaqësisë Diplomatike Konsullore gjegjësisht zyrës konsullore të Republikës së Maqedonisë në Konfederatën Zvicërane me adresë në Kirchenfeldstrasse 30, 3005 Bern.

Për atë qëllim, Ju lutemi për informim të anëtarëve të shoqatave tuaja.

Faleminderit paraprakisht për bashkëpunimin e Juaj.

Ambasada e RM në Bern

